



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 916/2 prot

Datë 16.04.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me nr REF-97585-03-06-2024 me objekt “**Blerje e artikujve ushqimor**” me fond limit 17,783,380.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-03-2024 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.

Ankimues: Operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK
Adresa: Lagja Tre Heronjt, Rruga Pal Engjelli Zona Kadastrale Nr 8596 nr pasurie 10/630 4001, Shkodër

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkoder
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër

Në datën 16.04.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në fome shkresore eshte depozituar ankesa me nr. 916 prot., e operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me nr REF-97585-03-06-2024 me objekt “Blerje e artikujve ushqimor” me fond limit 17,783,380.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 25-03-2024 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “EL-GJO 2006” SHPK në ankesën nr. 916 datë 16.04.2024 pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Oferta juaj refuzohet per keto arsye:

1-Nuk plotesoni piken 2.2.1”Kapaciteti ekonomik dhe financiar” te DST, per vleren e xhiros mesatare vjetore ,pasi vlera vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar 2022, 2021 dhe 2022 eshte më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht 17,783,380 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

2-Nuk keni plotesuar piken 2.3.6.Kapaciteti teknik, pasi nuk keni plotesuar tabelen nr.1, ku duhej te deklaroni kontratat e furnizimit qe ju dispononi.

3-Ne formularin e Vetëdeklarimit sipas shtojces nr.8 keni deklaruar si subjekt mbeshtetes Martin Dede Vata per te cilin nuk keni paraqitur një Formular te veçantë te Vetëdeklarimit, sipas percaktimeve te DST,ku citohet si me poshte:

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

4-Ne shtojcen nr.1 keni deklaruar vleren 9,983,870 leke pa tvsh ndersa tek shtojca nr.2 Lista e artikujve keni deklaruar vleren prej 16,089,000 leke, duke patur mosperputhje ne deklarimet e vlerave te ofertuara.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.04.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri